



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

Drejtoria e Përgjithshme
e
Policisë së Shtetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI

Nr. 468/2 Prot, datë 17.02.2012

Nr. 23 Prot, datë 16.01.2012

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

dhe

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Me synimin e përbashkët për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

Me qëllimin për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e bashkëpunimit dypalësh për parandalimin e diskriminimit, respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut gjatë veprimtarisë për përmbushjen e misionit dhe të përgjegjësive ligjore të dy institucioneve, në përputhje me zbatimin e legjislacionit respektiv të secilit institucion;

Me objektin garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sigurimin e të drejtës së çdo personi për, brarazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat e për të gëzuar liritë, për mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, sipas fushës së veprimtarisë që ato mbulojnë;

Me angazhimin për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin mbi bazën e parimit të reciprocitetit;

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 8137 , datë 31.07.1996 " Për ratifikimin e Konventes Evropiane "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", Ligj nr.9264, datë 29.07.2004 "Për Ratifikimin e Protokollit nr.12 të Konventës "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", Ligj nr.7767, datë 09.11.1993 "Për Aderimin në Konventen "Për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave", Ligj nr.7768, datë 09.11.1993 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për Zhdukjen e të Gjitha Formave të Dallimit Racor", Ligj nr.8496, datë 03.06.1999 "Për ratifikimin e "Konventës kuadër të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Minoriteteve", Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", Ligjin Nr. 9749, datë 04.06.2007, "Për Policinë e Shtetit", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (me poshtë te referuara palët),

Palët,

Bien dakort si më poshtë:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

- 1.1 Kjo marrëveshje ka për objekt ndalimin e sjelljeve diskriminuese dhe përcaktimin e rregullave e modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike dhe marrjen e masave për mbrojtjen nga

diskriminimi në përputhje me ligjet respektive, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe vënia para përgjegjësisë ligjore të autorëve dhe personave përgjegjës që kryejnë veprime, mosveprime, qëndrime diskriminuese apo shkelin dhe nuk respektojnë të drejtat njeriut.

Neni 2

Të drejta dhe detyrime të përbashkëta të palëve

2.1 Palët angazhohen dhe do të bashkëpunojnë me njëra tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara nga aktet ligjore dhe nenligjore sipas fushave të veprimtarisë që ata mbulojnë, bashkëpunim i cili do të përfshijë:

- Shkëmbim ekspertize dhe angazhim reciprok për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushat respektive;
- Të nxisin mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok;
- Shkëmbim informacioni dhe njohurish;
- Organizim i fushatave të përbashkëta sensibilizuese dhe trainimeve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen nga diskriminimi në shërbimin policor;
- Bashkëpunim i ndërsjelltë me synim evidentimin e problemeve të personave që janë ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit si dhe marrjen e masave pozitive;
- Shkëmbim ekspertize, nëpërmjet zhvillimit të tryezave të përbashkëta të diskutimit apo seminareve të ndërsjellta, edhe me aktorët përgjegjës me qëllim forcimin e zbatimit të legjislacionit;
- Organizime takimesh të përbashkëta, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në shërbimin policor;
- Të kërkojnë mendimet dhe sugjerimet e Palës tjetër për përmirësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim përfshirjen e masave të reja që garantojnë trajtimin e barabartë;
- Bashkëpunim në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare që i shërbejnë zbatimit të ligjeve respektive.

2.2 Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera për të cilat mund të bihet dakort në të ardhmen.

Neni 3

Komunikimi i Palëve

3.1 Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo

informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore.

- 3.2 Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
- 3.3 Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.
- 3.4 Me anë të përfaqësuesve të dyja Palët do të përcaktojnë radhën e mbledhjeve të grupeve të punës, kohëzgjatjen dhe periodicitetin e këtyre mbledhjeve.

Neni 4

Dispozita të Fundit

- 4.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet pa afat të caktuar.
- 4.2 Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes, duke njoftuar palën tjetër 30 ditë para.
- 4.3 Marrëveshja mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të Palëve të paraqitur me shkrim.
- 4.4 Në rast mosmarrëveshje të dyja Palët i zgjidhin ato nëpërmjet negociimit dhe mirëkuptimit.
- 4.5 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, dy për secilën palë.
- 4.6 Ky Memorandum Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Palët.

Nënshkruar në Tiranë, më 17/02 / 2012.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E POLICISË SË SHPETIT**

HYSNI BURGAJ

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

IRMA BARAKU

KOMISIONERI

